



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 162/2prot.,

Datë 30.01.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “4 S” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur - mbi kufirin e lartë monetar*” me Nr. REF-51771-12-01-2022, me objekt: “*Blerje Ushqime për Vitin 2023*”, me fond limit 315,108,746.00 lekë pa TVSH, Loti III me objekt: “*Blerje bukë thekre dhe integrale*” me Nr. REF-51781-12-01-2022 me fond limit: 22,595,339.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 04.01.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopështeve Tiranë.

Ankimues:

“4 S” SHPK
Adresa: Lagja “*Xhevdet Nepravishta*”, Rr. “*Qerim Arapi*”,
Pasuria nr. 23/104-N4, Lushnje

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopështeve Tiranë
Adresa: “*Rruga e Barrikadave*”, Tiranë

Në datën 27.01.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr.162 prot., e operatorit ekonomik “4 S” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur - mbi kufirin e lartë monetar*” me Nr. REF-51771-12-01-2022, me objekt: “*Blerje Ushqime për Vitin 2023*”, me fond limit 315,108,746.00 lekë pa TVSH, Loti III me objekt: “*Blerje bukë thekre dhe integrale*” me Nr. REF-51781-12-01-2022 me fond limit: 22,595,339.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 04.01.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopështeve Tiranë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “4 S” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “4 S” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 162 prot., datë 27.01.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

1.1 Kriteret e veçanta, Kapaciteti Teknik pika 2.3.1, dokumentacioni i paraqitur në SPE nga operatori ekonomik për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera brenda 3 viteve fundit, nuk e plotëson 40% e vlerës të përllogaritur të kontratës që prokurohet për artikujt e ngjashëm.

1.2 Kriteret e veçanta, Kapaciteti Teknik pika 2.3.8 operatori ekonomik nuk ka paraqitur dëshmitë e testimeve zyrtare për mostrat, sipas përcaktimeve në specifikimet teknike të kërkuara në dst për artikujt:

1.2.1 Artikulli Bukë thekre

Ne raport analizen e paraqitur nga Laboratori Bio-V, mungon vula e akreditimit, që do te thotë që për këto tregues ky laborator është i pa-akredituar.

1.2.2 Artikulli: Bukë integrale

Ne raport analizen e paraqitur nga Laboratori Bio-V, mungon vula e akreditimit, që do te thotë që për këto tregues ky laborator është i pa-akredituar

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 30.01.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri